

Përmbledhje

Programi Operacional i FSHZH-së

2022-2028

Programi Operacional i FSHZH-së është një dokument planifikimi, i cili organizon në një plan operacional 7 vjeçar objektivat strategjike të institucionit, politikën e Qeverisë së Shqipërisë për Zhvillimin social-ekonomik, drejtimit e zhvillimit rajonal dhe kohezionit siç janë përcaktuar në Ligjin nr. 102/2020, si dhe programet aktive në zbatim nga FSHZH dhe ato të dakorduara.

Programi Operacional 2022-2024 është një program që zbatohet nga FSHZH miratuar nga Komiteti Drejtues i FSHZH-së nr. 225 datë 23.03.2022, në bazë të Ligjit Nr.10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”.

Programi Operacional i FSHZH-së 2022-2028, paraqet 5 drejtimit kryesore ku do të fokusohen ndërhyrjet transformuese nga FSHZH në përmbushje të objektivave strategjike të zhvillimit rajonal.

Programi përcakton buxhetin 7 vjeçar që do të mbështes realizimin e tij nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, Financimit të huaj, Grantet e BE si dhe bashkëfinancim nga përfituesit. Baza e financimit për periudhën 2022-2024 është PBA dhe zërat përkatës të buxhetit të përcaktuar në të.

Drejtimit e programit

Programi përcakton 5 drejtimit kryesore në të cilat ato të përqendrohen ndërhyrjet në territor si dhe kategoritë e ndërhyrjeve për çdo drejtim.

Përcaktimi i këtyre drejtimitëve është bërë duke përthyer drejtimitet strategjike kombëtare, programin e Qeverisë Shqiptare, politikën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, strategjitë sektoriale, ndërhyrjet e realizuara nga apo në zbatim nga FSHZH në territor si dhe ndërhyrjet e planifikuara nga aktorët publik kyç në nivel rajonal dhe vendor në drejtimitet e përcaktuara në Ligjin nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin.

Bazuar tek synimet strategjike të programit, metodologjia e ndërhyrjes, parimet dhe vlerat, janë identifikuar ato drejtimitet të cilat energjizojnë elementët e sistemit të jetës në mënyrë të drejtpërdrejtë si dhe japin vlerën maksimale të integruar mes njëra-tjetrës në territor duke garantuar zhvillimin në nivel të territorit ku ndërhyhet dhe të rajoneve si një strukturë unike.

Metodologjia e përcaktuar në program për identifikimin dhe lidhjen e ndërhyrjeve në territor, përcakton nevojën e konsultimit të gjere me aktorët rajonal dhe përthithjen e ideve dhe propozimeve prej tyre. Duke filtruar këto ide dhe propozime në baze të drejtimitëve, kategorive dhe tipologjive të ndërhyrjeve si dhe potencialeve dhe situatës faktike në çdo rajon, do të identifikojmë ndërhyrjet konkrete për tu realizuar nga ky Program operacional.

Drejtimitet janë si më poshtë:

Drejtimi Strategjik 1 “TRANSFORMIMI I INFRASTRUKTURËS RAJONALE DHE VENDORE”

Synohet rigjenerimi urban, rigjenerimin mjedisor dhe infrastruktura ekonomike si dhe konektiviteti mes tyre;

Habitati urban ku zhvillohet aktiviteti jetësor ka nevojë për rikthimin e funksionalitetit dhe transformimin në hapësira të reja zhvillimore duke krijuar pole të reja jetese, të cilat sjellin frymën e zhvillimit dhe ndryshimit nëpërmjet ngritjes së zonave të reja të banimit, argëtimit etj. Përveç ndërhyrjeve që përmirësojnë pëlhurën urbane ekzistuese, zhvillimi i zonave urbane të reja mundëson ri-ekuilibrimin e zonave funksionale të qytetit në tërësi. Rritja e kapaciteteve të reja në shërbime dhe objekte banimi në një zonë me akses më të favorshëm do të orientojë zhvillimin dhe vendosjen e aktiviteteve të reja jashtë zonave problematike. Ri-kalibrimi i hapësirave ekzistuese duke rritur numrin e hapësirave të përbashkëta si ngritja e këndeve të lojërave për të ofruar facilitate të shpërndara në zonat urbane krahas ndërhyrjeve zhvillimore të cilat mbeten në rrugë, shihen si një mënyrë për të transformuar cilësinë e jetës në vend.

Drejtimi Strategjik 2 “ENERGJIZIMI DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE SHERBYESE TE NJVV”

Programi Operacional, do të synojë një transformim energjizues të qeverisjes vendore duke ofruar mbështetje shumë dimensionale përmes fuqizimit të sistemit të organizimit të bashkive

Qeverisja qendrore është aktive në rolin e saj qeverisës të vendit duke ndërmarrë reforma të forta të njëpasnjëshme dhe politika zhvilluese në sektorë strategjikë në vend, ndërkohë që shfaqen vështirësi nga ana e qeverisjes vendore për të patur të njëjtin ritëm duke mos arritur të krijojmë sinergji në territor, veçanërisht në nivel ndër bashkiak dhe rajonal.

Qeverisja vendore prej kohësh shfaq problematike të performancës dhe efikasitetit të jo efikas dhe financiarisht të qendrueshëm. Këto problematika lidhen me menaxhimin e aseteve, mungesën e ofrimit të shërbimeve ose ofrimin e tyre me kosto të lartë, pamundësinë e operimit dhe mirëmbajtjes së investimeve me standarde dhe kosto të lartë investimi, duke shpenzuar më shumë se sa munden ose duke mos arritur të operojnë apo mirëmbajtur në nivelin e duhur investimet. Ky është një efekt zinxhir ku si pasojë e mungesës së burimeve financiare, stafëve të pakualifikuara, shpenzimeve të larta dhe të ardhurave të ulëta, mos mbledhjes së taksave, gjenerohen më pak shërbime cilësore, më pak vende pune, më pak zhvillim.

Drejtimi Strategjik 3 “INOVACIONI DHE ENERGJIZIMI I AKTIVITETIT PRODHUES, RAJONAL DHE VENDOR”

Drejtimi i transformimit ekonomik do të fokusohet tek transformimi i prodhimit në nivel rajonal dhe vendor duke e orientuar atë drejt inovacionit.

Kombinimi i inovacionit në prodhim me stimulimin e partneriteteve ekonomike, me ndërhyrjet në infrastrukturën ekonomike si dhe mbështetjen e start-upeve dhe inkubatorëve të ideve do të krijojë infrastrukturën dhe habitatin e nevojshëm për kalimin e ekonomisë prodhuese në një nivel tjetër që nuk shkëmben vetëm lëndë të parë por kalon në nivel më të lartë në zinxhirin e vlerës dhe fillon të operojë në sektorë ekonomikë më të sofistikuar me normë të lartë fitimi.

Drejtimi Strategjik 4 “NDËRVEPRIMI DHE SINERGJIA MES GRUPEVE TË INTERESIT TË ZHVILLIMIT RAJONAL DHE VENDOR”

Sistemi social/shoqëror, është sistemi që ka në thelb marrëdhëniet njerëzore. Problematika e sistemit shoqëror shihet në mungesën e frymës komunitare si edhe në mungesën e bashkëpunimit. Mungesa e bashkëpunimit shfaqet në të gjithë elementët e tjerë të sistemit, atë urban, ekonomik, etj. Mungesa e bashkëpunimit dhe partneritetit në ekonomi krijon kosto të shtuara për prodhimin, tregtinë, operimin e biznesit, marketimin dhe shitjen, uljen e vlerës për shkak të konkurrencës së lartë, etj. Të njëjtat fenomene i shohim në zhvillimin e habitatit ku ndërtimet urbane, përdorimi i tokës, shërbimet terciare e të tjerë copëzohen duke krijuar një keqpërdorim të burimeve natyrore, hapësimore apo manaxheriale. Për këtë arsye, rritja e niveleve të ndërveprimit dhe rritja e sinergjisë mes qeverisjes qendrore, lokale, institucioneve të dijes, bizneseve dhe shoqërisë civile, është hallka e munguar për të patur rajone më të zhvilluara në të ardhmen dhe komunitete që rrisin mirëqënien mbi bazën e ndërveprimit.

Ndërhyrjet e parashikuara në këtë drejtim do të synojnë krijimin e partneriteteve të reja dhe zhvillimin e aktiviteteve që ndihmojnë në rritjen e ndërveprimit social.

Drejtimi Strategjik 5 “ZHVILLIMI I KAPITALIT NJERËZOR DHE AKTIVITETIT TË QENDRAVE TË DIJES NË NIVEL RAJONAL DHE VENDOR.

Njeriu është hallka kyç që lidh të gjithë elementet e sistemit të jetës. Nëse ne nuk kemi njerëz në një territor sado i begatë të jetë nuk do të kemi as ekonomi, as jetë shoqërore as qeverisje. Njëlloj siç vlen edhe e kundërta, çdo element i sistemit sado të sofistikohet dhe transformohet, nuk do të mund të kishte vlerë pa transformuar dhe aftësuar njerëzit.

Investimin në kapitalin njerëzor dhe aftësimin e tij nëpërmjet gjenerimit të qendrave të dijes në nivel rajonal dhe vendor dhe rrjetëzimit të tyre, ngritja bazave të të dhënave dhe përpunimit të tyre, sisteme IT, laboratore shkencore dhe qendra kërkimesh do të sillte një zhvillim të vendit dhe një mirëfunksionin të sistemit.

Krijimi i platformave prezantuese të potencialit të rajoneve apo krijimi i platformave për shkëmbim kapacitetesh do të kishte vetëm ndikime pozitive dhe progresive të Shqipërisë. Nga ana tjetër, do të kishim një shpërndarje më të drejtë dhe do të përfitonim një zhvillim gjithëpërfshirës dhe jo të centralizuar.